

Produkti i Brendshem Bruto në 2007(Paraprake)

Ruhet ecuria e rritjes

Rritja e volumit të produktit të brendshem bruto për vitin 2007, në vleresimet akoma jo përfundimtare, (referencë kalendari i rinovuar i publikimit të shifrave të PBB) ka arritur në 6.26 % (pas rritjes prej +5.53 % të vitit 2006).

Nga llogaritjet e deritanishme të vitit 2007 krahasuar me vitin 2006 në termat e rritjes të volumit, rritjet më të larta u shënuan nga sektori i shërbimeve ne pergjithesi (+13.0%), sektori i ndërtimit (+4.4 %), ndërsa bujqësia pas ritjes vetem prej 3.0 % në vitin 2006, arriti në 1.1 % në 2007. Gjatë vitit 2007 sektori i industrise pesoi nje rrenie te ndjeshme (-16.3%), kryesisht ne degen e industrise elektrike.

Tendenca e ngadalësimit të rritjes ekonomike të vendit, (nga rreth 9 % për vitet 1993-1996, në një mesatare prej rreth 6.0 % për vitet 2000-2007) është e njëjtë edhe me modelin tipik të rritjes ekonomike të vëndeve në tranzicion, ku karakteristikë është një përqindje më e lartë e rritjes në vitet e para me tendencë zvogëlimi më pas.

Të ardhurat për frymë vetëm 5 vitet e fundit kanë arritur në nivelin mesatar prej 2.081 € (2.617 \$ USA).

Sipas vlerësimeve të fundit, kjo vlerë në vitin 2007 është rreth 2.514 € (3.437\$ USA).

Shërbimet, gjatë dekadës së fundit janë sektori që zënë peshën më të madhe në ekonominë shqiptare dhe përfaqësojnë 50-60 % të vlerës së shtuar (vlerësuar në çmimet bazë korrente dhe neto nga FISIM). Vetem për vitin 2007, shërbimet llogariten të zene rreth 59.0%. Nga ana e tyre, industria dhe ndërtimi sëbashku përfaqësojnë 22.5 % të ekonomisë shqiptare në vitin 2007, edhe pse pesha mesatare e tyre gjatë dekadës së fundit ishte me pak 15%. Bujqësia siguroi rreth 18.5 % të të ardhurave shqiptare në vitin 2007 edhe pse e ka ulur peshën e saj me 49.4 % krahasuar me vitin 1996.

Struktura e vleres se shtuar sipas aktiviteteve ekonomike, ne % ndaj vleres se shtuar bruto nga FISIM (me cmime korrente)

STRUKTURA E PRODHIMIT TE BRENDSHEM BRUTO SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

